

NJOFTIME TË TJERA

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA, UNIVERSITETI I TIRANËS

Njoftim për vend të lirë pune

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Statutin e UT-së të miratuar me Urdhërin Nr. 816, datë 26.12.2018 të MASR, kërkon të punësojë në vendet e lira të punës për personel Ndihmës Akademik me karakter Administrativ me kohë të plotë pranë Njesisë Kryesore si më poshtë:

Kandidatët që konkurojnë për “Specialist për procesin mësimor në Departamentin e Gjuhës Frënge” në Degën e sekretarisë dhe e procesit mësimor” duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Master i Shkencave, Master Profesional ose DIND.
2. Të zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj të komunitetit të BE-së.
3. Të njohë programet bazë kompjuterike.
4. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
5. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Kandidatët që konkurojnë për “Specialist për procesin mësimor në Departamentin e Gjuhës Angleze” në Degën e sekretarisë dhe e procesit mësimor” duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Master i Shkencave, Master Profesional ose DIND.
2. Të zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj të komunitetit të BE-së.
3. Të njohë programet bazë kompjuterike.
4. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
5. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.

Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës që aplikon;
2. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të notuar). Për diplomat e marra në universitete e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e notuar e certifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse ;
4. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (të notuar);
5. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit;
6. Kopje e librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore;
7. Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë;
8. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
9. Dëshmi e zotërimit të programeve bazë kompjuterike;
10. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarim;

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentave është nga data 27/03/2023 – 10/04/2023.

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Njoftim për vend të lirë pune

I. Përshkrimi i vendit të punës

Pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, është 1 (një) vend i lirë pune si “Specialist Finance” - pranë zyrës së Financës dhe Buxhetit. Për nevoja të realizimit dhe mbështetjes së veprimtarisë së institucionit, duhet të realizohet procedura e rekrutimit për këtë pozicion pune.

II. Kriteret e përgjithshme për kandidatët

Kandidati/ja që aplikon për këtë pozicion pune, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, duhet të plotësojë këto kriteret të përgjithshme:

1. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojë diplomë të studimeve universitare të nivelit të parë dhe të dytë, dega Financë.
3. Të zotërojë aftësitë e punës në grup dhe komunikimit profesional.
4. Të zotërojë aftësitë profesionale specifike për vendin e punës.
5. Të mos ketë kryer krime të parashikuara nga Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Kandidatët të dorëzojnë në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në ASA (Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 3, Tiranë), brenda datës 25.04.2023, dosjen e kandidimit. Asnjë aplikim nuk pranohet pas këtij afati. Dokumentet e dosjes nuk kthehen.